

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe nenit 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK) në vazhdimin e parë të seancës së pesëdhjetë e shtatë të mbajtur më 21.12.2021 miratoi

#### Vendim

Procedura për kontrollimin e fletës anketuese të \_\_\_\_\_, ish-deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. NDËRPRITET

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm të KSHPK-së për lëndën me numër 08-3455/1 datë 05.10.2020.

Lënda me numër 08 –3455/1 të datës 05.10.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

#### Arsyetim

Lënda me numër 08-3455/1 nga data 05.10.2020 për kontrollimin e fletës anketuese të \_\_\_\_\_, ish-deputet i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është formuar me vetiniciativë .

Pas realizimit të mbikëqyrjes në evidencës, KSHPK-ja konstatoi se personi \_\_\_\_\_ në afatin e paraparë me ligj prej 30 ditësh pas përfundimit të mandatit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nuk ka dorëzuar deklaratë për pasurinë dhe konfliktin e interesit në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

KSHPK-ja përpiloi raport për kundërvajtjen dhe urdhërpagesën e konstatuar dhe ia dorëzoi personit \_\_\_\_\_, ndërsa i emëruari nuk veprroi sipas urdhërpagesës së lëshuar. Lidhur me këtë, KSHPK ka dorëzuar Kërkesë për iniciimin e procedurës për kundërvajtje komisionit për kundërvajtje në KSHPK të regjistruar me nr. 08-240/1 nga 15.01.2021.

Komisioni për kundërvajtje më datë 13.09.2021 miratoi Vendim me të cilin \_\_\_\_\_ është shpallur përgjegjës dhe i është shqiptuar gjobë për kundërvajtjen e kryer.

KSHPK, pas shqyrtimit të lëndës, konstaton se nuk ka elemente për veprimin e saj të mëtejshëm kompetent në rastin konkret.



Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: Mr. Nikolina Tarçullovaska-Miloshevska, këshilltare  
Miratoi: Goran Trpenoski, anëtar

KOMISIONI SHKETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
KRYETAR,  
Biljana Ivanovska